

URDHËR
Nr. 1, datë 9.1.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH-së”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Gjykatën Kushtetuese, Sekretarit të Përgjithshëm, zotit Kujtim Osmani.
2. Kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor të Gjykatës Kushtetuese do të ushtrohen për periudhën 9.1.2017, deri më 31.12.2017.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bashkim Dedja